



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

**Nr.20, datë 16.03.2018**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E ZGJEDHJEVE TË KËSHILLIT  
STUDENTOR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, MIRATUAR ME  
VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 68, DATË 21.12.2017 “PËR MIRATIMIN E  
RREGULLORES ...”**

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma a) dhe d) të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, shkresën e Komisionit të Apelimit të UMT-së nr.1 prot., datë 12.03.2018 “Kthim përgjigje”, protokolluar nga Rektorati i UMT-së me nr.469/1 prot., datë 12.03.2018 dhe shkresën nr. 2 prot., datë 15.03.2018 “Informacion lidhur me veprimtarinë e KAS” protokolluar nga Rektorati i UMT-së me nr. 469/3 prot., datë 15.03.2018, Relacionin e Komisionit Institucional Zgjedhor nr.156/1 prot., datë 12.03.2018 “Relacion” protokolluar nga Rektorati i UMT-së me nr.469/2 prot., datë 12.03.2018, dhe mbështetur në diskutimet e zhvilluara mbi situatën e krijuar në procesin zgjedhor studentor, me qëllim realizimin e një procesi të rregullt dhe transparent, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

- I.** Në Rregulloren për Zgjedhjet e Këshillit Studentor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 68, datë 21.12.2017 “Për miratimin e rregullores ...” shtohet neni 31/1 me përmbajtje si më poshtë:

**Neni 31/1**

1. Vendimet e Komisionit të Apelimit Studentor (KAS), të marra deri sot më 16.03.2018, mund të apelojnë nga vetë të interesuarit në Komisionin e Apelimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë brenda orës 16:00 të datës 19.03.2018. Vendimi do të merret brenda 24 orëve nga KA UMT dhe do të jetë i formës së prerë.
2. Procesi i votimit do të zhvillohet në prani të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve përkatëse të UMT-së.

3. Procesi i vlerësimit dhe numërimit të votave do të kryhet nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (KZF) nën vëzhgimin e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Studentor (KZS) të fakultetit përkatës, kandidatëve për kryetar/anëtar të këshillit studentor të fakultetit si dhe vëzhguesve të tyre.
  4. Ambjentet e KZS-ve të fakulteteve përkatëse të UMT-së në të cilat do të numërohen votat e studentëve do të regjistrohen audio dhe video me kamera sigurie.
- II.** Pika 7 e nenit 8 të Rregullores për Zgjedhjet e Këshillit Studentor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ndryshohet si më poshtë:
- “Vendimi i KAS mund të apelohej në Komisionin e Apelit (KA) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Vendimi i KA së UMT-së është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për tu zbatuar”.
- III.** Pika 1 e nenit 19 të Rregullores për Zgjedhjet e Këshillit Studentor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, shfuqizohet.
- IV.** Pika 2 e nenit 19 të Rregullores për Zgjedhjet e Këshillit Studentor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ndryshohet si më poshtë:
- “KZF-ja e fakulteteve përkatëse të UMT-së, nën vëzhgimin e KZS-së, pas numërimit të votave plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS-së”.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Apelit të UMT-së, Komisioni Institucional Zgjedhor i UMT-së, Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve (KZF) të UMT-së, Komisioni Apelit Studentor (KAS), Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor (KIZS) dhe Komisionet Zgjedhore Studentore (KZS) të fakulteteve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-se dhe u njoftohet të personave sipas pikës III të këtij vendimi.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. ARBEN GJATA**